



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 57 Prot.,

Tiranë, 01.03 2024

VENDIM
Nr. 49, datë 01.03.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saq”, Vendimit Nr. 792, datë 7.10.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategorive të licencave, procedurave për dhënien, pezullimin ose revokimin, si dhe kuotizacionit vjetor të licencave për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale”, ndryshuar me Vendim Nr. 329, 02.06.2021, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 01.03.2024:

VENDOSI:

- Miratimin e kërkesës së **Z. Faikjon Belaj**, për pajisje me Licencë individuale në Projektim (P), në veprimtari ndërhyrëse në pasuri kulturore materiale për kategorinë (A), në nënkategorinë:
 - P/A/5 - Projektim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së traditës (vernakulare);
 - Mosmiratimin e kërkesës së Z. Faikjon Belaj për pajisje me Licencë individuale në Projektim (P), në veprimtari ndërhyrëse në pasuri kulturore materiale për kategorinë (A), në nënkategoritë P/A/2, P/A/3, P/A/4, P/A/7, pasi nuk plotëson numrin e projekteve si pjesë e ekipit projektues, në secilën nga këto nënkategorori.
 - Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
 - Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta QIRICI

